



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-15826/21 datë:05.07.2021



Npi – 01/209 datë: 14.07.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 14.07.2021 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I M B L E D H J E S Ë -VII- TË R R E G U L L T TË K U V E N D I T TË K O M U N Ë S Ë S H T I M E S**  
E mbajtur më: 14.07.2021, (e mërkurë) në ora 10.<sup>oo</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, znj.Arbenita Halimi, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi. Në mbledhje përveq anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli, Drejtorat, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati; Nga zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, Nga OJQ “YAHR” – z.Egzon Ahmeti, Lerd Salihi, Agron Gashi, Fatlum Bllaca, Leon Avdiu, Allen Avdiu, Denis Avdiu; Nga zyra për Informim, z.Lulzim Sahiti. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Pyetje – Përgjigje,
2. Raporti financiar i Komunës për Periudhën Janar-Qershor 2021,
3. Propozim-Vendim për bartjen e mjeteve finan. nga kategoria e rezervës në projekte kapitale,
4. Propozim-Vendim për shpronësimin e pronave në Z.K-Shtime, Petroviç, Reçak, Petrovë,
5. Rishqyrtimi i Statutit të QKMF “Vezir Bajrami” Shtime, Npi-01/150 sipas MPL-së,
6. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/151 për vendosjen e Shtatores “Adem Jashari” sipas MPL-së,
7. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/152 për zhvendosjen e Skulpturës “Tri Tytat” sipas MPL-së,
8. Informate nga Komisioni për Verifikimin dhe Destinimin e Banesave Komunale,
9. Informatë e përgjithëshme nga KKSB-ja,
10. Shqyrtimi i Kërkesës të Shoqatës “Jezerci” Komuna – Ferizaj.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për rendin e ditës.**

**z.Ruzhdi Jashari;** Përshëndetje, ne kemi kërkuar edhe në KPF por po kërkojmë edhe këtu në Kuvend që pika e 4 të hiqet nga rendi i ditës, për shumë arsye, e para është kohë e fushatës parazgjedhore dhe mund të hapen pazare të ndryshme. E dyta nuk ka specifikim të emrave dhe të pronave që duhet shpallur me interes të përgjithshëm. Pastaj e treta nuk kemi mjete financiare të aprovuara për këtë destinim. Këto duhet të specifikohen mirë e mirë, të njoftohen pronarët e tokave, të bisedohet me ta dhe pastaj të vjen në Kuvend propozim-vendimi për shqyrtim. Sa i përket vendimit që ka të bëjë me EDA-ë kuvendi e ka miratuar një vendim ku sqarohet kjo se Komuna nuk ka asnjë obligim ndaj bizneseve për punët dhe pronat që i kanë pasur në shfrytëzim aty (te zona ekonomike) Për këtë arsye ne po kërkojmë të largohet kjo pikë sepse duam që të respektohet Ligji dhe procedurat.

**z.Naim Zejna;** Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës edhe pse është kërkuar që të silllet në Kuvend një material për te pusët e Ujësjiellit. Unë propozoj që të hiqet nga propozim-vendimi pronat te Zona Kadastrale – Petroviç, sepse dihet që aty puna është pak e megjullueme, dmth. të hiqet pika e katërt e propozim-vendimit.

**z.Perparim Ramusa;** Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës. Këto prona që duhet me u shpronësuar ne i kemi shtruar asfalt, dhe kemi llogari ndaj qytetarit që ti shpronësojmë sepse janë prona private.

**z.Isak Muslija;** Përshëndetje, kur të krijohet buxheti duhet të gjindet një mënyrë për ti kompensuar këta pronarë. E jo që ne jemi kundërshtarë, mirëpo po themi jo tash në kohën e zgjedhjeve për ti ble votat në mënyrë moderne.

**z.Naim Zejna;** Propozimi im nuk është për pronat që i ka marrë komuna për interes publik, por është për pronat e Armend Sadik Abazit. Për sa i përket pronave të tyre nuk është i njëjti veprim. Prandaj unë e mbroj qëndrimin që nuk duhet të shpronësohen.

**z.Ruzhdi Jashari;** Dua ta bëj të qartë edhe një herë që propozimi ynë është që pika e katërt në tërësi të hiqet nga rendi i ditës. Këto çështje që po përmenden të Xhaferit dhe Sadik Abazit janë krejt çështje individuale.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorimin prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 19 vota “Për” me 5 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.

#### Pika 1

##### Pyetje – Përgjigje

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Fillimisht të gjithë bashkatdhetarëve u urojmë mirëseardhje në vendlindje. Kam këto pyetje: Nga qytetarët e Godancit te epërm është kërkuar që të hiqen disa pengesa në rrugën Godanc-Zborc? Pyetja e dytë, viti shkollor po përfundon, duhet të bëhet trotuari në rrugën “Skender Qarri” në Shtime?

**znj.Shqipe Rerxhaj, drejtoreshë e DPUKGJ;** Përshëndetje, unë realisht nuk e kam të qartë se për far kërkese dhe për far projekti po bëhet fjalë.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Jap unë përgjigje,

**z.Muhamet Ademaj;** Kam këto pyetje: Ne duhet ta kemi një informatë nga Drejtoria e Arsimit, se sa nxënës ka me nota të dobëta në shkollën profesionale?

**z.Ruzhdi Jashari;** Ka kundërmim gjithandej në Shtime nga kanalizimet. Lumi është zverdhë nga fekaljet. Në shumicën e rasteve nuk kemi përgjigje në pyetjet tona, kësaj here kam këto pyetje konkrete: Pse nuk ka ujë të pijes në shkollën fillore në Petrovë? Pyetja e dytë, kur do të përfundojë qështja e grumbullimit të berlllogut në komunën e Shtimes? E treta, pse nuk na vijjnë Procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve me rregull kur e dimë se me një zyrtarë nuk mund të arrihet të kryhen të gjitha punët, ndërkaq që ka zyrtarë në Komunë që vetëm rrijnë.

**z.Herolind Selmani:** Përshëndetje, kam këto pyetje: A është anuluar konkursi për ndarejen e bursave për student, dhe kur pritet me u hapë konkursi i ri?

**z.Besnik Seferi:** Përshëndetje, nuk kemi marrë përgjigje në pyetjet e kaluara. Në vazhdim ky lexoi një letër, (përmbajtjen e së cilës nuk e kam nxanë). Kam këto pyetje: A ka mundur të bëhet diçka më shumë për sa i përket punës të firmës STN “Betoni” me qëllim që të mos shkaktojë shqetësim të banorët e fshatit Davidovc? Pyetja e dytë, në fshatin Pjetërshticë është një rrugicë 78 metra, kur do të asfaltohet? Një pyetje për Shëndetësi: Në QKMF-ë gjatë orarit të pauzës pse nuk organizohet një kujdestari, por pacienti është i detyruar të pret gjysëm ore për ti ofruar shërbim?

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Përshëndetje, u ngritën disa pyetje, sa i përket rrugës Godanc-Zborc e kemi paraparë rregullimin e sajë me KAB për vitin 2022, ndërsa banorët nuk kanë bërë pengesa për zgjerimin e sajë. Edhe për ndërtimin e trotuarit do të bisedojmë në buxhetin e vitit 2022. Për mësimdhënësit, kërkojmë të jenë transparent dhe të bëjnë vlerësimin e drejtë. Në kohën e fundit është e vërtetë se kemi pas rrjedhje të ujërave të zeza mbi sipërfaqe, dhe kjo është si pasojë e zhvillimit të punëve në projektin e madh të ndërtimit të Kolektorit për trajtimin e ujërave të zeza. Nga nesër do të startojmë me punën e trajtimit të shtratit të lumit. Ujësjiellësi në komunën tone është shtri në 90% të fshatrave, mirëpo me furnizimin e me ujë nuk jemi të kënaqur, mirëpo siç e dini kjo është kompetence e Kompanisë Publike KRU “Prishtina” njësia në Shtime, ku si aksionarë është Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne kemi pas takime me drejtorin e Kompanisë për këtë çështje edhe të furnizimit me ujë por edhe të kanalizimit. Puset që po hapen janë çështje tjetër, të cilat nuk bëhen nga Buxheti i Komunës, ndërsa donatorët i falënderojmë për projektet e tyre. Kemi biseduar edhe me Kompaninë Publike “Pastërtia” për ti përmirësuar shërbimet. Ne po planifikojmë që të kemi konkurent për hapsirat tjera që nuk mundet me i menaxhuar kompania “Pastërtia” sepse Ligji e mundëson një gjë të tillë. Të gjitha ato kompani që emitojnë pluhur në hapsirë, Inspektorati ka ndërmarrë hapat dhe ka shqiptuar dënimet. Jemi duke e shqyrtuar mundësinë që pjesa e betonjerkës të zhvendoset komplet nga ai lokacion, kështu që së bashku me Ministrinë e linjës do të ndërmarrim hapat e kordinuar. Në fshatin Pjetërshticë janë duke u asfaltuar rrugët dhe aty do të kemi 90% të rrugëve të asfaltuara. Në total mund të themi se infrastruktura rrugore është e kompletuar. Kështu pra edhe kjo rrugë që e ngriti Besniku do të trajtohet.

**znj.Agime Roshaj, drejtoreshë e DKA;** Përshëndetje, për një pjesë të madhe të pyetjeve i dha Kryetari. Jemi duke vazhduar mësimin sipas skenarit A. Mësimdhënësit e kanë autonominë e plotë për me vendosur vetë lidhur me vlerësimin e nxënësve.

**z.Musa Baftiu, drejtor i DSHMS;** Përshëndetje, sa i përket pauzës është e lejuar me ligj. Në QKMF-ë puna bëhet në bazë të standardeve dhe konceptit që i përket Mjekësisë Familjare. Aty ka mundësi që pacienti me e zgjedhë mjekun. I falënderoj punëtorët e QKMF-së për punën e tyre.

## Pika 2

### Raporti financiar i Komunës për Periudhën Janar-Qershor 2021

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Fillimisht lexoi Rekomandimet e KPF-së, dhe në vazhdim për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

**znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar;** Përshëndetje, në vazhdim zyrtari kryesor financiar lexoi dokumentin me shifra konkrete sipas tabelave. (shih dokumentin) Në fund delegatët i ftoi që ta votojnë raportin financiar për periudhën janar-qershor 2021. Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

**z.Naim Zejna;** Ky vit është pak më i mirë në krahasim me vitin e kaluar, kjo për shkakun e pandemisë Covid19. Te tabelat do të ishte më mirë sikur të paraqiteshin mer përqindje psh. te administrata mallra dhe shërbime, kemi vetëm 35% shumë mjaft e vogël në krahasim me alokimet, e pak më e madhe në krahasim me buxhtin. Brengosëse është se paret i kemi e nuk po mund ti hargjojmë, dmth. 45 % të këtyre mjeteve nuk kemi mund me i shpenzuar.

**z.Fehmi Hysenaj;** Faleminderit për ekspozimin e ZKF-së ku shihet një rritje dhe aktivitet më shumë. Si janë bërë pagesat, dhe far obligimi kemi karshi këtyre pagesave? E përkrahu Naimin kur tha lidhur me mos shpenzimin e mjetve finqanciare, kur faktikisht janë parat.

**z.Perparim Ramusa;** Kemi një raport më të mirë, dhe gjendje më të kënaqshme, kur dihet që kemi pas një periudhë dimërore dhe me pandemi. Kështu që unë nuk do ta zgjas por propozoj që të kalojë sipas rekomadimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**z.Ruzhdi Jashari;** Për sa i përket shpenzimeve a ka pas planifikim për shpenzime, dhe a ka pas buxhetim për to. Këto duhet me u pasqyruar në raport, e jo mos me ditë, e as mos me pa në raport.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Disa pyetje të përgjithshme e kanë vetë përgjigjen. Raporti shprehë gjendjen reale të gjendjes financiare. Pjesa e parë e buxhetit është administrative, ndërsa dinamika e punëve bëhet në pjesën e dytë. Asnjë operatorë nuk pret për pare, pas projektit të kryer. Shërbimet dhe mallrat janë në dinamikën e tyre, që lidhën me periudhën paraprake. Kjo është dinamikë normale. Pandemia ka shkaktuar vonesa në qeverinë tonë dhe asaj Austriake, në projwektin e Kolektorit, mirëpo tash punimet kanë filluar. Pengesa për shpenzime nuk kemi pas për faktin se nuk kemi pas asnjë obligim. Në momentin që e kemi vendimin e prerë atëher e bëjmë zotimin. Te shpenzimet e kemi kuotën e mjaftueshme, për sa i përket shpenzimeve.

**znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar;** Teknikisht raporti është i punuar sipas standardeve. Raportin e kemi thjeshtëzuar dhe punuar ashtu që më lehtë të kuptohet. Te shpenzimet mjetet janë të planifikuara edhe për vitin 2021 edhe për vitin 2022 do të planifikohet.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorimin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 6 vota “Abstenim” aprovoi Raportin Financiar të Komunës për Periudhën Janar-Qershor 2021.**

### **Pika 3**

**Propozim-Vendim për bartjen e mjeteve finan. nga kategoria e rezervës në projekte kapitale**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

**znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar;** Meqenëse e keni marrë me kohë dokumentin unë nuk do ta zgjati shumë, por po i përmendi vetem ato që janë më kryesore, në vazhdim lexoi dokumentin, (shih dokumentin). Po sqaroj se i kemi bërë edhe përmirësimet të kërkuara nga ana juaj. Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorimin prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” aprovoi vendimin për destinimin e Rezervës Buxhetore Komunale, në riemërtimin e projekteve kapitale.**

### **Pika 4**

**Propozim-Vendim për shpronësimin e pronave në Z.K-Shtime, Petroviç, Reçak, Petrovë**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** E njoftoi Kuvendin me Njoftimin e z.Hajrush Ademaj, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Ruzhdi Jashari;** Është shkelje e vendimit të Kuvendit të vitit 2007, ku Komuna nuk merr asnjë obligim, për asnjë çështje që lidhet me pronat te Zona Ekonomike, e që nënkupton edhe të Xhafer Hysaj. Ky është obligim i punëkryesit i cili nuk ka punuar si duhet. Kjo është në kundërshtim me ligjin dhe kjo duhet të konstatohet në procesverbal, po flas me emra sepse kjo është edhe për të mirën e tyre.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Po sqaroj, se të gjitha pronat që janë me propozim --vendim, janë duke u ashfrytëzuar nga publiku, ato ose janë rrugë ose parqe. Të gjitha pronat i dini ju vetë se ku janë. Ekzekutivi e kryen punën e vetë sipas vendimit të Kuvendit. Te prona e Xhafer Hysaj është një dëm që i është shkaktuar në këtë rast pronarit. Komuna bartë obligim për pronat me interes të

përgjithshëm. Komuna e ka në shqyrtim për ta paditur kompaninë për dëmet e shkaktuara. E kuptoj që është para fushatë, por edhe qytetari e kupton se cila është gënjeshtër.

**z.Fehmi Hysenaj;** Për disa prona janë plotësisht kundër që të shpronësohen, por edhe planifikimi nuk ka qenë i mirë, sepse po sillemi para aktit të kryer. Te trotuari një pronar i ka hjekë kubzat dhe i ka gjuajtë në lumë. Unë po kërkoj që të gjitha pronat të sqarohen një nga një.

**z.Naim Zejna;** Asnjë pronë nuk është e një kategorie, sepse nuk janë të njejta. Te pronat në Z.K. – Reçak jam “për”, ndërsa te pronat në Z.K. – Petroviq unë jam që të hiqen, te Petrova jam që të kalojë por te prona e Hajrush Ademaj jam që të sqarohet më shumë. Përgjegjësia jonë është që pronat private duhet të trajtohen. Në Z.K. – Petroviq është e megjulluar, qasja ndaj interesit publik. Në qmimin shitës të parcelës është kalkuluar edhe qmimi shitës i saj bashkë me rrugë. Blehet lirë e shitet shtrejtë. Këtu unë jam që të hiqen.

**z.Perparim Ramusa;** Mirë qëka debat. Fillimisht unë mendoj se kjo nuk është kundër ligjore. Të gjitha pronat që janë ardhur këtu janë për interes publik, kështu që këto prona duhet me u paguar. Qështja e parcializimit, të gjithë ata pronarë janë të atyre tokave, nuk mund të bëjmë diskutim që dikujt me ja paguar e dikujt jo.

**z.Muhamet Ademaj;** Ky është mandati i dytë i imi. Unë në vitin 2014 kam pas një kërkesë, për hapjen e rrugës te Lagja Ademaj për nxënës. Në vitin 2016 është hapur rruga, të cilën e kemi kërkuar nga KFOR-i Turk. Ne i kemi lëshuar pronat, edhe unë e kam lëshuar pronën time. Ka pas ankesa nga prindi Hajrush Ademaj, kështu që kjo rrugë është mbyllur në vitin 2016. Kemi pas edhe padi në gjykatë por unë e kam tërhequr këtë padi, kështu që unë i lus kolegët që ta përkrahin shpronësimin e kësaj rruge.

**z.Nim Zejna;** Nuk është e vërtetë që gjithë këtyre pronarëve të tokave sipas propozim-vendimit ua kemi marrë pronat. Është e vërtetë që në Reçak ua kemi marrë pronat, por në Petroviç nuk kemi marrë kurrfar prona, por shpronësimi është për interesin e personave të caktuar, e ne tash si Kuvend me ua paguar pronat e tyre.

**z.Ruzhdi Jashari;** Kjo administratë nuk ka më funksionalitet, pse rrinë aty e marrin rroga gjeodetët. Pse nuk bëhet me kohë Planifikimi, dhe matjet gjeodezike, por i merret prona qytetarit nga ekzekutivi i komunës pa kurrfar plani e pa kurrfar marrvëshje, e pastaj vini këtu në Kuvend dhe kërkon shpronësimin e tyre. Askush nuk është kundër shpronësimit të pronave private, sepse ajo është e mbrojtur me ligj, por duhet të përfillen procedurat për realizimin e projekteve. Nuk ka specifikim të projekteve në të cilin do të duhej të përfshihej edhe qmimi i shpronësimit. Të pronat në Z.K.-Petroviç, coptohen pronat, e pastaj Komuna mule me i shpronësuar.

**z.Perparim Ramusa;** Çdo pronë e marrë nga Komuna duhet me u shpronësuar, qoftë rrugë, trotuar ose park.

**znj.Shqipe Rexhaj, drejtroresh e DPUKGJ;** Listën e keni që nga fillimi i vitit, dhe ajo është mediatike. Ju mundeni me e refuzuar por palët kanë të drejtë me ju quar në gjykatë.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Unë po besoj që diskutuesit patën mundësinë me i pas të qarta gjërat. Jeni të obliguar me i ditë sepse jeni qe 4 vjet këtu për me ditë secilën pronë se ku është. Por secilën pronë duhet shpronësuar, nëse është vullneti i Kuvendit. Rruga “Tranzit” nga pishat deri në Godanc secila metër katrorë është e shpronësuar nga Ministria e Financave. Në aspektin ligjor krejt është okej, e drejta e juaj është me e votuar, si të doni.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorimin prej 14 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi, vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pronat private komplet sipas propozim-vendimit të ekzekutivit.**

## Pika 5

### Rishqyrtimi i Statutit të QKMF "Vezir Bajrami" Shtime, Npi-01/150 sipas MPL-së

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Fillimisht lexoi Rekomandimet e KPF-së, dhe në vazhdim për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Musa Baftiut.

**z. Musa Baftiu, drejtor i DSHMS;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, sqaroi këtë pikë duke theksuar se ne jemi që të qëndrojmë pranë këtijë vendimi.

**Kryetari, z. Naim Ismajli;** Duke pas parasysh Udhëzimin Administrativ që shumica e QKMF-ve Në Kosovë kanë emërtime të tilla të ngjashme, duhet që ose të ndryshohet Udhëzimi Administrativ sepse ne nuk mund tani që ta ndryshojmë historinë e këtyre emërtimeve. Prandaj unë them se Kuvendi duhet të qëndrojë në vendimin e parë.

**z. Perparim Ramusa;** Kemi rekomandimin e KPF-së, dhe kemi vendimin e Kuvendit për emërtimin e QKMF-së "Dr. Vezir Bajrami" nuk kemi asnjë arsye që ta ndryshojmë këtë emërtim. Unë jam që të mbetet emërtimi i njejt i QKMF-së në Shtime.

**z. Fehmi Hysenaj;** Edhe unë jam që të qëndrojmë pranë vendimit të njejtë me emërtimin e QKMF-së "Dr. Vezir Bajrami". E di që brenda ditës Udhëzimi Administrativ mundet me u ndryshuar, prandaj këshillë e jona si Kuvend është që të ndryshohet Udhëzimi Administrativ e jo vendimi i Kuvendit.

**z. Ruzhdi Jashari;** Te kjo pikë Statuti i QKMF-së është aprovuar. Vendimi i Kuvendit është më i hershëm dhe duhet respektuar. Por ne kemi vendime që janë marrë e që nuk janë respektuar, siç janë shkollat në Shtime në Carralevë. Jewmi që kjo më hecë përpara por Ministria me gjetë dakordancën.

**z. Naim Zejna;** Vërejtje, fillimisht të konstatohet kuorimi e pastaj të votohet. Nuk kemi këtu problem me emrin por me emërtimin e QKMF-së, ne duhet të mbetemi te vendimi i mëparshëm e mMinistryria pastaj nëse do le të merret nëpër Gjykata. Unë jam që të mbetemi te vendimi i njejt.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Ne për secilin venim që marrim fillimisht e konstatojmë Kuorumin e mjaftueshëm. Me këtë rast Konstatoj kuorumin se kemi 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, unanimisht vendosi të konfirmojë, se qëndron pranë vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-0/149 të datës: 03.06.2021, për aprovimin e Statutit të QKMF-së "Dr. Vezir Bajrami" në Shtime.

## Pika 6

### Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/151 për vendosjen e Shtatorës "Adem Jashari" sipas MPL-së

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Shqipe Rexhaj.

**znj. Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ;** Përshëndetje, Ministria e ka kthyer vendimin në rishqyrtim me arsyetimin se nuk është e paraparë me Planin Zhvillimor të komunës, por Plani Zhvillimor nuk e cakton se ku mundet e ku nuk mundet për me u vendosë ndonjë shtatore.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Lexoi Rekomandimin e KPF-së.

**z. Ruzhdi Jashari;** Mirë që nuk kanë ndodhur veprime ende. Krejt kanë lidhje me Planin Hapsinor, dhe në vazhdim lexoi pjesën e kërkesës së Ministrisë për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

**z. Fehmi Hysenaj;** Më ka befasuar Ministria, që me na lënë peng, për shkak se nuk i kemi ende hartat zonale. Unë mendoj se ne duhet të mbetemi te vendimi i njejtë.

**z. Shefki Dauti;** Përshëndetje, unë po mendoj se ky është vendim shumë i qëlluar që e kemi caktuar lokacionin për shtatoren e Adem Jasharit. Ministria po fusin huti, ne duhet ta qartësojmë se këtu nuk bëhet fjalë për ndërtesa. Unë mendoj se ne duhet të qëndrojmë pranë vendimit të Kuvendit. Pastaj kur bëhen hartat i harmonizojmë ato.

**z. Naim Zejna;** Ne nuk mundemi me centimetra me punu këtu. Dihet që te sheshi i UÇK-së edhe kaq, e tash qka qitet aty, sigurisht që nuk qitet shtatorja e Macetungut, është e qartë kjo se aty do te vendoset shtatorja e Komandantit të UÇK-së "Adem Jashari" dhe ne presim që të kuptohemi, kështu që ne duam që të qëndrojmë në këtë vendim.

**z.Ruzhdi Jashari;** Sigurisht që ne jemi për, por duhet që të jemi në përputhje me Ligjin.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Secili akt e ka pasuesin e vet të Ligjshmërisë. Kuvendi ka marrë vendim të drejtë. PZHK-ja e as Hartat Zonale nuk specifikojnë detajet se ku mund të vendoset një shtatore. Ne nuk ndeshemi me Planin Zhvillimor. Komuna nuk është e obliguar që të saktësojë në detaje se ku duhet të vendosen plalkat përkujtimore, buste e shtatore. Skemi qka harmonizojmë, janë të harmonizuara dhe qka kemi ne me bërë ndryshe.

**z.Fehmi Hysenaj;** Pajtohem me fjalën e Kryetarit, sepse ne duhet ta kemi të qartë se ku në cilën pikë shkelet PZHK-ja.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorimin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” vendosi të konfirmojë, se qëndron pranë vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-0/151 të datës: 03.06.2021, për vendosjen e shtatores të Komandantit Legjendar të UÇK “Adem Jashari “ në Sheshin (trekëndëshin) e qytetit të Shtimes.

#### Pika 7

Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/152 për zhvendosjen e Skulpturës “Tri Tytat” sipas MPL-së  
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk pati diskutime Kryesuesja konstatoi kuorimin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” vendosi të konfirmojë, se qëndron pranë vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-0/152 të datës: 03.06.2021, për zhvendosjen e Skulpturës “Tri Tytat” nga Sheshi i UÇK-së ku gjendet tani dhe të vendoset në mes të udhëkryqit të fshatit Belinc (lokacioni ku kryqëzohen rrugët Shtime-Carralevë-Zborc), afër varrezave të Dëshmorëve në qytetin e Shtimes.

#### Pika 8

Informate nga Komisioni për Verifikimin dhe Destinimin e Banesave Komunale

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Milot Deliu.

**z.Milot Deliu, kryesues i Komisionit;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, lexoi informatën e përgatitur me shkrim, (shih dokumentin). Në vazhdim ai tha ne si komision kemi të identifikuar 9 banesa të pa shfrytëzuara të Komunës. Ne do të shikojmë mundësinë që të marrim edhe informata të tjera plotësuese për këtë çështje.

**z.Isak Muslija;** Faleminderit për informatën, unë jamë anëtarë i komisionit, dhe ate që mund ta them në këtë moment është se kam mungesë të informacioneve të duhura. Për këtë çështje.

**z.Shefki Dauti;** Edhe unë jam anëtarë i komisionit, unë kam qenë i menimit për me shty për mbledhjen e radhës, me qëllimin më të mirë që ta diskutojmë në mënyrë të detajuar. Do të ishte më e mira që komisioni me dalë në teren me konstatu gjendjen mirë dhe me bërë një rekomandim për Kuvëndin.

**z.Rexhep Gashi;** Jam pjesë e komisionit, kemi mbajtur disa mbledhje, materialin e kemi marrë vetëm 13 orë përpara, ndërkaq që unë mendoj se Kuvendi duhet me pasë edhe procesverbalin e mbledhjeve të komisionit. Duhet me u ditë saktë se kush kanë qenë firmat që kanë punuar. Pa procesverbal pak se mund të flitet këtu në Kuvend për këtë çështje.

**z.Fehmi Hysenaj;** 1/3 e anëtarëve të Kuvendit kanë qenë në këtë Komision, nuk e ka kryer punën për pjesën e destinimit të banesave. Dokumentet na tregojnë se si ka shkuar puna. Nëse e ka kryer punën komisioni mirë dhe ka verifikuar, ashtu si është në letër është edhe në teren. Unë po pyes a i ka verifikuar këto komisioni.

**z.Perparim Ramusa;** Faleminderit për informatën, për ne vërtetë janë disa informata bazë, mirëpo unë e inkurajoj komisionin që me na e sjellë një raport më të detajuar.

**z.Ruzhdi Jashari;** Është e pa justifikueshme që banesat rrinë, e qytetarët nuk kanë kulëm mbi kokë ose një numër i tyre kanë nevoja të mëdha për banim. Këtu shihet më së miri keqqeverisja. Në punën e komisionit kanë munguar 4 anëtarë. Sa i përket kësaj qëshetje ka informata e thash e theme sa te duash, e që këto duhet të ndriçohen si psh. kush menaxhon, të kujt janë vërtetë banesat, kah erdhën pronarët, le të hallakaten të gjitha, sepse aty ka pas arkitekt të ndryshëm. Duhet me u zbardhë mirë të gjitha detajet duhet me u bindë edhe unë si antar i Kuvendit por edhe qytetari për statusin e këtyre banesave, pastaj ne mund të vendosim se qka po veprojmë me to.

**z.Naim Zejna;** Faleminderit për informatën, a është kjo kontrata e vitit 2008 apo pak më e hershme? Sa i përket verifikimit dhe destinimit, destinimi është pak më i lehtë. Mua më brengos një aneks kontratë, a i kemi humbur dy njësi me këtë aneks, apo zvoglohen njësitë tjera që janë 10, që ka ndodh për shkak të rrëshqitjes së dheut. Ai e ka ditë lokacionin, e ne prap me i dhënë banesa për shkak të përshkallzimit të terrenit aty?

**z.Isak Muslija;** Dokumentacioni është shty, dhe nuk na ka ardhur. Ngecja e ka pas arsye dikund tjetër e jo te komisioni. E tha kryesuesi i komisionit se do ta vazhdojmë punën. Detyra jonë është të grumbullojmë shkresat dhe të verifikojmë gjendjen në teren, brenda kompetencave që i kemi.

**z.Milot Deliu;** Si komision i kemi bërë disa punë, i kemi mbajtur disa mbledhje dhe kam përgatitur një informatë të shkruar. Materiali është kërkuar nga ekzekutivi dhe është dërguar te anëtarët e komisionit ku i kanë marrë me kohë. Aneks kontrata parasheh murin mbrojtës dhe ato që janë të shkruara aty. Në mbledhjet e radhës do të shikojmë dhe do të analizojmë një nga një dhe do të dalim me një rekomandim.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Komisioni, për gjithë dokumentacionin që kërkon, nuk ka asnjë problem, ne ju paisim me dokumentacionin cili ka shkruar përmes prokurimit publik. Edhe për këto dy banesat para Komune edhe te QKMF-ja, ju ofrojmë dokumenta sepse ka dokumente të mjaftueshme.

## Pika 9

### Informatë e përgjithëshme nga KKSB-ja,

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Naim Ismajlit.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Po duket se edhe ju jeni lodhur, meqenëse informatën e KKSB-së e kani marrë të shkruar, nuk do të ju lodhi që të përsëriten gjërat, unë besoj se e keni lexuar informatën kështu që nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem, (shih dokumentin).

**z.Besnik Seferi;** Gjendja e përgjithëshme e sigurisë është e qetë. Së fundmi cilët kanë qenë hapat që të parandalohet përdorimi i lëndëve narkotike, kur kemi informata se Qendra Rinore është bërë strehë e narkotikëve. Çfarë hapa janë marrë? Te sinjalizimi, kemi kërkuar vendosjen e shenjave për zvoglimin e shperjtësisë, kur dihet që kemi pas aksident të rëndë ku humbën jetën dy të rinjë. Çka është bërë me sinjalizimin? Tjetër, është bërë e pa mundur lëvizja e lirë e qytetarëve nëpër trotuarë prej veturave të parkuara. Çfar hapa janë ndërrmarrë për ti liruar trotuarët?

**z.Muhamert Ademaj;** Po shihet se po mungon prezenca e policisë nëpër vendbanimet lokale, kërkoj që policia të jetë më shumë prezente edhe nëpër vendbanimet lokale e jo vetem në qendër.

**z.Fehmi Hysenaj;** Unë po kërkoj nga KKSB-ja që të prononcohet lidhur me kategorizimin e Stacionit Policor në Shtime, spse ne nuk mund të jemi të barabartë me Ranillukun.

**z.Isak Muslija;** Siguria është më e gjërë se sa në aspektin që po flasim. Dsiguria është edhe aspekti i furnizimit me ujin e pijes, pastaj me prerjen e pyjeve. Çka keni bërë përveq mbledhjeve të mbajtura. Preventiva është dazshur të ndërrmirret sepse është më e mirë e cila e parandalon shkaktimin e dëmit.

**z.Ruzhdi Jashari;** Siguria është e rregulluar me ligj, dhe në aspektin praktik ka një kuptim shumë më të gjërë. Përveq atyre që u përmenden nga kolegët, siguria është mbrojtja në punë e shumë segmente të tjera. Jemi të shqetësuar shumë për veprimet narkotike në komunën e Shtimes. Ne nuk po shohim se far veprime janë ndërrmarrë, aspekti i preventivës është krejtësisht në mungesë. Pastaj



kohëve të fundit gjithnjë e më shumë po përhapen zjarre fushore, qka po ndërrmirret që dukuria e zjarrvënjes me qëllim të parandalohet?

**z.Naim Zejna;** Mua po më intereson dezinfektimi a do të bëhet? Pastaj çështja e sigurimit të ujit të pijes sepse pas ndodhjes së rastit të infektimit të ujit në Deqan po ndihemi mjaft të brengosur? Dhe çështja tjetër dikush po kërkon me i vendos pengesat e shpejtësisë e dikush po kërkon me i hjekë ato, si do të veprohet?

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Informatën që e keni marrë është e detajuar. Ka të spacificuara të gjitha ne i identifikojmë çështjet dhe i adresojmë. Nga KKSJ-ja adresohen në institucionet përkatëse. Ka projekte konkrete që kanë dalë nga KKSJ-ja. Janë marrë hapa konkret edhe te zjarret edhe te shenjzimi. Pastaj vizitat mjeksore nga QKMF-ja në familje dhe shkolla. Të uji rasti i Deqanit na ka alarmuar që të shohim rrjedhën e ujit nga burimi deri te rubineti në një shkollë, lokal apo shtëpi.

Deri sot uji i pijes nga KRU "Prishtina" është në nivelin më të lartë. Edhe ne si Komunë i bëjmë analizat si formë e rutinës për me e verifikuar kualitetin e ujit. Ka edhe mungesa të shenjave në pjesën e rrugëve lokale ne i adresojmë këto, por për rrugët rexhionale i adresojmë në linjën përkatëse. Çështja e Stacionit të Policisë ka 8 vjet që ka dështuar, por e vërteta është se Shtimja ka ngelur në nivelin e ulët. Ne mendojmë se Shtimja duhet të kalon në nivelin B sepse është numër i vogël i policëve në krahasim me numrin e banorëve.

#### Pika 10

##### Shqyrtimi i Kërkesës të Shoqatës "Jezerci" Komuna – Ferizaj

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Unë paraprakisht kam folë me udhëheqësin e Shoqatës "Jezerci" nga komuna e Ferizait z.Fadil Sejdiu i cili nga Kuvendi i Komunës tonë ka kërkuar që me një deklaratë ta përkrahim në angazhimin e tyre për sa i përket pronave të konfiskuara nga pushteti i kaluar i paraluftës, duke pas parasysh se disa nga pronat përfshihen edhe në territorin e komunës tonë. Kështu që ka kërkuar konkretisht që ta përkrahim me një deklaratë.

**z.Isak Muslija;** Unë e kam lexuar këtë dokument për ato prona. Në periudha të ndryshme komuna e Shtimes ka të humbura prona edhe në Jezerc me komunën e Farizait por edhe në Carralevë me komunën e Suharekës. Këto çështje duhet ti rregullojë Kuvendi i Kosovës me Ligj. Problemi është se komuna jonë ka humbur territor shumë të madh edhe në drejtim të komunës së Ferizait edhe në atë të Suharekës. Pronat duhet të ju kthehen pronarëve herë do kur do.

**z.Nazim Zejna;** E kam parasysh kërkesën e Shoqatës "Jezerci" mirëpo unë kam pritë që ne ta kemi para-veti një propozim-deklaratë. I pamë 168 vendime të Gjykatave që u kanë dhënë palëve për kthimin e pronave. Unë jam që ta bëjmë një deklaratë të tillë, ose e lëmë për mbledhjen e radhës.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Unë e kam një formë të kësaj deklarate që mund ta përcjelli që ta shihni.

**z.Ruzhdi Jashari;** Po mundohem me dhënë një kontribut konkret për këtë çështje. Po kërkohet një e vërtetë e pronave që kanë qewnë nëpër Gjykata. Pronat që i përdorin ata që shumë vite pa u penguar nga askush por realisht atyre u mungojnë letrat e pronësisë. Kemi edhe në komunën tonë prona të tilla mjaft shumë që duhen rregulluar dhe të paisen pronarët me letrat e pronësisë. Hapi i parë që duhet bërë është që Komuna e Shtimes mos me lejuar ndërrim pronari pa u verifikuar se a ka kontest Gjyqësor, kështu që le të shkon lënda dhe të procedohet më lartë. Komuna e Ferizait e ka ngritur këtë çështje, kështu që edhe komuna jonë duhet ta ngritë për ta adresuar mirë këtë çështje.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorimin prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 14 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" aprovoi Deklaratën me anë të së cilës shprehim solidaritetet dhe perkrrahje për banorët e fshatit Jezerc – Komuna e Ferizait, si vijon:


1. Të kërkoj nga të gjitha institucionet kompetente që ti implementojnë këto vendime me prioritet dhe në përputhje me të drejtat e garantuara me kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare për të drejtën e pronës.

2. Të kërkoj nga institucionet kompetente që të krijojë një komision për ti verifikuar pronat tjera për të cilat nuk kemi dokumentacion por që janë të kufizuara dhe që të gjithë banorët i dinë pronarët e tyre.

3. Të kërkoj nga të gjitha institucionet që asnjëra nga pronat kontestuese mos të jepet në shfrytëzim, deri në momentin që përfundojnë procedurat administrative dhe ligjore për këtë kontest,

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 13.24h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj

